



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në një tërësi anë;

Dhe

KONTRAKTORI "MENTI" Shpk Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. Islam Shoshi, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810298556 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

**NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN KOVRAGË – LAGJA
KAJTAZAJ-BEKAJ – Lot 3**

<i>Nr. I prokurimit</i>	633-20-3118 - 5-2-1/ C 276
<i>Nr. I brendshëm</i>	633 / 020 / 041 / 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN KOVRAGË – LAGJA KAJTAZAJ-
BEKAJ – Lot 3**

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN KOVRAGË –LAGJA KAJTAZAJ-BEKAJ – Lot 3** është: 18.976,40 € dhe me fjalë:

Tetëmbëdhjetë mijë e nëntë çindeshtatë dhjetë e gjashtë euro -40/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjës së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet në afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit të se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 30.11.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet në afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të përgjigjet për demet eventuale të shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për




pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për: Autoritetin Kontraktues:
KOMUNA E ISTOGUT**

**Për: Kontraktuesin:
"MENTI" Shpk**

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>Islam Shoshi</i>
Pozita:	<i>Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>D r e j t o r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>7/9/2020</i>	Data:	<i>07.09.2020</i>
Vu la		Vu la	

TRIMËSI AKTIVE

2014-2015

Speçifikimi / punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Çmimi Njës (3)	Gjithëgj (Zëri)
Punët përgatitore				
1 Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përfillimit të planit dhe programit punues si dhe gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i perkohshëm i tyre	aprox	1	600.00	600.00
2 Demolimi i rrethojave metalike prej telave me gjemba dhe demolime të tjera të mundshme si shtylla etj, ngarkimi dhe bartja deri në deponinë e qytetit deri në 5km distancë	m ³	600	0.60	360.00
3 Sanimi i trasës para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit	m ²	435	1.50	652.50
			subtotali	1,612.50
2 Punimet e dheut				
2.1 Germimi i dheut të kategorisë III-IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 5km. Germimi të bëhet në thellesi deri në 25cm	m ³	489	2.5 €	1 222.5 €
2.2 Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje me vibrocilinder deri në 30MN/m ²	m ²	1,957	0.2 €	391.4 €
2.3 Punimi i bankinave me trashësi t=10cm dhe gjeresi 0.5m me zhavor 0-31,5mm me ngjeshje- duke përfshirë përfshirë udhëkryqet dhe rrugët lidhëse me bankinen e rrugës	m ³	43	8.0 €	344.0 €
2.4 Furnizimi, transporti dhe vendosja e gypave të betonit për punimin e kaljes në fund të rrugës për depertimin e ujrave atmosferik etj. Gypat Ø500mm	copë	10	28.0 €	280.0 €
			subtotali	2,237.9 €
3 Mbistruktura				
3.1 Punimi i tamponit 120MN/m ² prej gurit të thyer gelqeror Ø=63mm me trashësi t=15cm	m ³	293	7.0 €	2,051.0 €
3.2 Punimi i tamponit 120MN/m ² prej gurit të thyer gelqeror Ø=32mm me trashësi t=10cm	m ³	195	8.0 €	1,560.0 €
3.3 Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e Asfalt betonit 0-16mm me trashësi t=7cm për tërë sipërfaqen e rrugës dhe atë me gjeresi 4m dhe 3m	m ²	1,645	7.0 €	11,515.00 €
			subtotali	15,126.0 €
TOTALI ME TË GJITHA NGARKESAT (GJITHSEJ 1+2+3)				18,976.4 €